

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr."Lidhja e Pejës" magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson [REDAKTUE], kundër të paditurit [REDAKTUE], me vendbanim në Ferizaj, rruga ' [REDAKTUE] p.n., për rimbursim dëmi, në seancën e mbajtur me datë 13.06.2018, në prani të përfaqësueses së paditëses e në mungesë të palës së paditur merr këtë:

**A K T G J Y K I M**  
- *në mungesë -*

**I. APROVOHET** kërkesë padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rr."Lidhja e Pejës", magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, si e bazuar.

**II. DETYROHET** i padituri [REDAKTUE], me vendbanim në Ferizaj, që paditëses të i'a paguajë shumën prej 312.00 €, me kamatë ligjore e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes padisë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**III. OBLIGOHET** paditësja të paguaj taksën gjyqësore për paraqitje të padisë në shumë prej 20.00 €, menjëherë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

**A r s y e t i m i**

Paditësja me padinë e ushtruar në këtë gjykatë me datë 17.12.2015, kundër të paditurit [REDAKTUE] me vendbanim në Ferizaj, në çështjen juridike për rimbursim dëmi, të cilës i ka bashkangjitur provat përkatëse lidhur me pretendimet faktike të paraqitura në padi.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e radhës me datë 13.06.2018, mirëpo edhe pse i padituri ka qenë i ftuar me rregull për të marrë pjesë në këtë sencë (*provë: fletëkthesë e datës 18.04.2018 e pranuar personalisht nga i padituri*) i njejti nuk ka marrë pjesë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar si dhe nuk ka kërkuar shtyerjen e seancës gjyqësore. Sipas propozimit të paditëses, gjykata ka aprovuar mbajtjen e seancës në mungesë të të paditurit.

Përfaqësuesi i paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i propozojmë gjykatës që ta obligojë të paditurin ta rimbursojë dëmin e shkaktuar si në shumën e cekur në padi, në shumë prej 312.00 €, me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.



Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtës të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë: *Urdhër pagesa e dt. 17.11.2012; vendimi në emër të BSK-së, FK-1859/2012 i dt. 07.11.2012; Ujdia jashtgjyqësore nr.1859/2012 e dt. 15.12.2012; vendimi i komisionit të shkallës së pare për trajtimin e dëmeve për caktimin e dëmeve me nr.1859/12 i dt.07.11.2012; aktvlerësimi i i demit me nr.1859/12 i dt.01.11.2012; fotografitë e automjetit që gjenden në shkresat e lëndës; procesverbali mbi dëmitimin e automjetit me nr.1859/12 i dt.30.10.2012; polisa e sigurimit në emër të [REDACTED]; libreza e automjetit në emër të [REDACTED] me nr.0345087; fletëparaqitura e demit në emër të [REDACTED] e dt.27.10.2012; raporti i policies nr.2012-LF-2396 i dt.27.10.2012.*

Bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 par 1 dhe 2 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia e paditëses është e bazuar.

Gjykata ka aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit, për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, meqenëse në rastin konkret janë përbushur konditat ligjore nga neni 151 par.1 pika a) deri e) të LPK-së, respektivisht se i padituri edhe pse ka qenë i ftuar me rregull, nuk ka marrë pjesë në këtë seancë si dhe mungesën e tij nuk e kanë arsyetur për këtë seancë, se nga gjendja e fakteve dhe provave të çështjes, rezulton si e themeltë kërkesëpadia e paditëses dhe se kjo gjendje e fakteve nuk është kontestuar nga i padituri, fakt ky i paraqitur edhe përmes përgjegjes në padi, gjithashu gjendja e fakteve është në harmoni me provat e prezantuara nga paditësja në padinë e saj dhe se nuk ekzistonë rrethana që janë të njohura botërisht për pengesat eventuale që i padituri të mos paraqitet në seanën e shqyrtimit kryesor të çështjes me datën 13.06.2018.

Andaj nga të theksuarat më lartë, gjykata ka vodosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 151 të LPK-së dhe nenit 378 të LMD-së.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës ka vodosur në bazë të nenit 452 par.1, ndërsa vendimin përr të obliguar fillimisht paditësen që të paguaj taksën gjyqësore për padi e ka bazuar në nenin 12 par.1 i UA nr.1/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS

C.nr.817/15, me datën 13.06.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSENZA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROSEVAC

Më  
Dana

24.08.2018

Gjyqtari,  
Misim Frangu

KËSHILË JURUAJNE: Këndër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet këshësi në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

